



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:277097

Datë: 18.09.2024

Numri i dokumentit: 06244690

KA.nr.697/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit F.S., Drejtor i IPSH “Olive Medical Group” SH.P.K., me seli në Prishtinë, i përfaqësuar sipas autorizimit nga Valon Leci, kundër të paditurës Inspektorati Shëndetësor Ministria e Shëndetësisë me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Fatlum Xhaçkaj, për shkak të anulimit të vendimit me nr.10/K-70-21 i datës 17.11.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 05.09.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të palës paditëse dhe të përfaqësuesit të palës së paditur, më datë 18.09.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit F.S. Drejtor i IPSH “Olive Medical Group” SH.P.K., me seli në Prishtinë kundër të paditurës Inspektorati Shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë me seli në Prishtinë me çka ka kërkuar të anulohet vendimi nr.10/K-70-21 i datës 17.11.202, i nxjerrë nga e organi shkallës së dytë të Inspektoratit Shëndetësor, Ud. Kryeinspektori Shëndetësor si dhe vendimi i shkallës së parë i së paditurës me nr. 10/A-70-21 i datës 11.10.2021 i Inspektoratit Shëndetësor dhe çështja të kthehet në rivendosje, **si e pa bazuar.**
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 09.12.2021, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, paditësi F.S.-Drejtor i IPSH “Olive Medical Group” SH.P.K., ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.2920/2021, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë-Inspektorati Shëndetësor me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit nr. 10/K-70-21 i datës 17.11.2021 me propozim që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadi e paditësit F. S.-Drejtor i IPSH “Olive Medical Group” SH.P.K, të anulohet dhe të shpallet nul vendimi me nr. vendimi me nr.10/K-70-21 i datës 17.11.2021 i Kryeinspektorit Shëndetësor si dhe vendimi i shkallës së parë i së paditurës me nr. 10/A-70-21 i datës 11.10.2021 i Inspektoratit Shëndetësor.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA nr. 697/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor më datë 05.09.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të palës paditëse Valon Leci sipas autorizimit të datës 25.08.2023, dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesit të palës së paditur Fatlum Xhaçkaj sipas autorizimit të datës 05.09.2024.

#### Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në pretendimet e dhëna në padi, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se konsiderojnë që dy vendimet e inspektoratit shëndetësor, vendimi i shkallës së parë me nr. 10/A-70-21 i datës 11.10.2021 me të cilin i është shqiptuar gjobë z. F.S. por edhe vendimi i organit epror nr. 10/K-70-21 i datës 17.11.2021 janë në kundërshtim me Ligjin në fuqi për Shëndetësinë si dhe Ligjin për Shoqëri Tregtare. Fillimisht Inspektorja shëndetësore në shkallë të parë gjobitë personin fizik F.S. i cili aso kohe ka qenë njëri nga aksionarët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara Olive Medical Group duke u referuar në nenin 94 par 1 nën paragrafi 1.3 sipas të cilit “gjobitet institucioni shëndetësor me gjobë prej 2000-8000 euro për shkelje administrative dhe kundërvajtje kur ushtron veprimtari pa licencë valide të punës sipas nenit 42 të ligjit për Shëndetësi”. Sipas përfaqësuesit të paditësit në këtë rast ka shkelje të dyfishtë të legjislacionit si dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Olive Medical Group në atë kohë ka pasur licencë valide meqenëse gjoba ka të bëjë me analizën

PCR Olive Medical Group ka pasur edhe vendimin nga Ministria e Shëndetësisë që i lejohet të i kryej këto analiza.

5. Tutje ka shtuar se shkelja tjetër konsiston në faktin që inspektorja shëndetësore gjobit F.S. si person fizik për shkeljet të personit juridik Olive Medical Group në kundërshtim të plot me ligjin nr. 06/EL-016 për Shoqëri Tregtare, neni 75 par.1 sipas të cilit SHPK-ja është person juridik e cila juridikisht është e ndarë nga aksionarët dhe vetë vetiu është bartëse e të drejtave dhe obligimeve, paragrafi 2 përcakton qartë që aksionari i SHPK-së, nuk është përgjegjës për borxhet ose detyrimet e SHPK-së vetëm për arsyet që është aksionar. Z.S. ka qenë vetëm njëri nga aksionarët e Olive Medical Group, ndërsa e paditura e ka gjobitur vetëm njërin nga aksionarët.
  
6. Ka theksuar se shkelje tjetër nga ana e inspektore është fakti kur është gjobitur Z. S. siç thotë inspektorja në vendim për mos ruajtje të mostrave që janë marr nga laboratorët tjerë duke ju referuar gabimisht nenit 94 par 2 nën paragrafi 2.3 i cili përcakton që institucioni shëndetësor gjobitet për mos ruajtjen e të dhënave të shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore sipas nenit 52 të ligjit ndërkohë që ky nen përcakton dhe flet për të dhënat personale por jo për mostra. Ndërsa asnjë dispozitë ligjore nuk obligon ruajtjen e mostrave sepse kjo do të ishte absurde por edhe e rrezikshme për shëndetin e stafit dhe pacientëve nga se në laborator çdo ditë merren dhjetëra mostra gjaku, strisho por edhe mostra të fecesit andaj është e rrezikshme në kuptimin shëndetësor që të njëjtat të ruhen në funksion të kësaj institucionet shëndetësor kontraktojnë kompani profesionale për asgjësimin e mostrave. Rrjedhimisht as neni 52 i Ligjit nr.04/EL-125 për Shëndetësinë dhe as Ligji nr. 06/EL-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mostrat e tilla nuk i konsideron si të dhëna personale. Inspektorja gjobit z. S. për shkelje të nenit 94 par 4 nën paragrafi 4.4 i cili përcakton që profesionisti shëndetësor dënohet me gjobë prej 1000-2000 euro në rastet kur ushtron kujdes shëndetësor duke mos iu përmbajtur parimeve etike dhe profesionale. Z. S. as nuk është profesionist shëndetësor dhe as nuk ka ofruar shërbime shëndetësore dhe as profesionale ai është thjesht njëri nga aksionarët. Në bazë të faturës të lëshuar nga e paditura është gjobitur F.S. dhe jo Poliklinika Olive. Prandaj gjykatës i propozon që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F. S., Drejtor i IPSH “Olive Medical Group” SH.P.K, të anulohet dhe të shpallet nul vendimi me nr. vendimi me nr.10/K-70-21 i datës 17.11.2021 i Kryeinspektorit Shëndetësor dhe

vendimi i shkallës së parë i së paditurës me nr. 10/A-70-21 i datës 11.10.2021 i Inspektores Shëndetësore Dr. A.M..

### Kundërshtimet e të paditurës

7. Përfaqësuesi i të paditurës në pretendimet e dhëna në përgjigje në padi sipas parashtrës së datës 15.04.2024 ka deklaruar se Inspektorati Shëndetësor i Republikës së Kosovës me kërkesën e policisë për Krime Ekonomike më datë 23.09.2021 ka bërë inspektimin specifik në poliklinikën IPSH Olive” Group SHPK në shërbim të laboratorit me pronar F. Spahiu, me qëllim të vërtetimit të bashkëpunimit të tyre me laboratorë tjerë, konkretisht me laboratorin “Mrika” në Vushtri, ku gjatë inspektimit është kontrolluar dokumentacioni mjekësor dhe është konstatuar se janë ruajtur mostrat e marra nga laboratorit përkatës. Sipas tij, pronari i paditësit ka theksuar se kanë bashkëpunuar me disa laboratorë të cilit iu sjellin mostrat ndërsa këta i bëjnë analizat dhe i dërgojnë raportet te laboratorit përkatës dhe i raportojnë IKSHPK-së, ku në laboratorit si mikrobiolog punojnë Dr.P.A. dhe Dr.Z.K..
8. Ka shtuar se nga inspektorët e rastit është konstatuar se fletë analizat nënshkruhen prej dy mikrobiologëve në të njëjtën kohë nga Dr. P.A. e cila ishte në pushim mjekësor, ndërsa pronari dhe personeli mjekësor për këtë çështje kanë pohuar se nënshkrimet i kanë të deponuara pasi që sistemi i qetë në mënyrë elektronike/automatike, ku në rrjedhim e sipër Inspektorati Shëndetësor më datë 11.10.20214 ka nxjerr vendim me nr. 05-864 duke i shqiptuar gjobë Z. F.S. në vlerë prej 3,000.00 euro për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore të nenit 94 par. 4 dhe nënë par. 4.4 i Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi, për shkak se i njëjti ushtron kujdes shëndetësor duke mos iu përmbajtur rregullave etike dhe profesionale. Ndërsa ankesën e paditësit të datës 19.10.2021 me nr. 05-864/2 Kryeinspektori Shëndetësor përmes vendimit me nr. 05-864/3 të datës 18.11.2021 e ka refuzuar si të pa bazuar. Lidhur me pretendimet e palës paditëse se Inspektorati Shëndetësor ka gjobitur personin fizik nuk qëndrojnë për faktin se me vendimin e datës 11.10.2021 është gjobitur F.S. në cilësi të themeluesit apo pronarit të Poliklinikës Olive SH.P.K dhe në bazë të arsytimit të vendimit dhe procesverbalin mbi inspektimin e kryer të datës 23.09.2021 gjithnjë bëhet fjalë për poliklinikën Olive me pronar F.S.. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadija e paditësit F.S., Drejtor i IPSH “Olive Medical Group” SH.P.K.

## Provat e administruara

9. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Raporti i inspektimit specifik me datë 11.10.2021 me nr.ref.10/A-65-21 nga Inspektorati Shëndetësor, Procesverbal mbi inspektimin e kryer me nr. rendor 01616 me datës 23.09.2021, Licencë me nr. 243/2017, Licencë e punës për specialistë mikrobiologji Dr. P.A., Licencë e punës për specialistë mikrobiologji Dr. Z.K. D., Rezultatet e testimit ISO nga paditësi me listën e pacientëve me të dhënat personale dhe rezultatet e testit për periudhën 23.07.2021, 03.06.2021, 01.07.2021, Kërkesë për pushim nga P.A. me datë 09.09.2021, Rezultati mikrobiologjik për pacientin R.K, Ankesë e paditësit kundër vendimit nr. 10/A-70-21 datë 11.10.2021, Vendimi i kundërshtuar me nr. 10-K-70-21 me datë 17.10.2021, Vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë me numër 243 /2017/2 me datë 04.08.2020 me të cilin aprovohet kërkesa e F.S.për testim për SARS COVID në institucion shëndetësor Olive Group, Faturë me numër 001251 për pagesë të gjobës në emër të F.S., Vendimi i shkallës së parë me nr.10/A-70-21 me datë 11.10.2021.
10. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenit 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, deklaratimet e përfaqësuesit të paditësit në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpapia e paditësit është e pa bazuar.
11. Me Vendim të Ministrisë së Shëndetësisë me numër 243 /2017/2 me datë 04.08.2020 aprovohet kërkesa e F.S. për testim për SARS COVID në institucion shëndetësor Olive Group, të llojit: Laborator Mjekësor Biokimik Hematologjik në kuadër të Poliklinikës “Olive Medical Group”.
12. Licenca me nr. 243/17 e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë për “Olive Medical Group”, me themelues F.S., me datë të vlefshmërisë nga 22.09.2017 deri më datë 21.09.2022. Dr. P.A. posedon Licencë të punës si specialiste në mikrobiologji nga 31.07.2012 deri më

datë 02.07.2023. Dr. Z.K. D. posedon Licencë të punës si specialiste në mikrobiologji nga 26.12.2017 deri më datë 26.12.2022.

13. Sipas procesverbalit mbi inspektimin e kryer me nr. rendor 01616 me datës 23.09.2021, Inspektorët shëndetësor kanë konstatuar se ky inspektim është bërë për të vërtetuar raportin dhe regjistrimin e pacientëve (mostrave) nga laboratorit “Mrika”. U konstatua se rastet e mostrave të arritura nga ky laborator ishin të evidentuara të gjitha mostrat në regjistrin e pacientëve. Për të gjitha mostrat të raportuara në IKSHPK është marrë dokumentacioni mjekësor. Në këtë institucion punojnë Dr. Z.K. dhe Dr. P.A.. Është urdhëruar që të ndalohet marrja e mostrave nga institucionet laboratorike të cilat nuk janë të licencuara për kryerjen e analizave përkatëse. Procesverbali është nënshkruar nga pala prezente F.S..
14. Sipas Raportit të inspektimit specifik me datë 11.10.2021 me nr.ref.10/A-65-21, është konstatuar se Inspektorati Shëndetësor i Republikës së Kosovës më datë 23.09.2021 ka bërë inspektimin specifik ndaj IPSH Poliklinika “Olive” në shërbimin e laboratorit. Inspektimi ishte zhvilluar në dy faza: Faza e parë me menaxherin dhe stafin shëndetësor, ku inspektimi ishte bërë nën shoqërimin e pronarit F.S.t si dhe personelit tjetër shëndetësor, faza e dytë kishte të bënte me inspektimin e institucionit dhe mbledhjen e dokumentacionit. Nga inspektorët shëndetësor në raport ishte konstatuar se IPSH “Olive” është i licencuar në Ministrinë e Shëndetësisë me nr. 243/2017 më datë 22.09.2017 deri më datë 21.09.2022. Në laboratorin e këtij institucioni si mikrobiologë punojnë Dr. P.A. me licencë pune valide deri më datë 02.07.2023 dh Dr. Z.K.-D. me licencë të punës valide deri më 26.12.2022. Sipas pronarit F.S. të njëjtit kanë bashkëpunim me laboratorët e tjerë të cilët ua sjellin mostrat ndërsa këta i kryejnë analizat dhe i dërgojnë raportet te laboratorët përkatëse dhe i raportojnë në IKSHPK. Pas analizës së dokumentacioneve mjekësore të njëjtit kanë konstatuar se rastet e mostrave të arritura nga laboratorit “Mrika”, ishin të evidentuara në regjistër të pacientëve të laboratorit “Olive”, në laboratorin e IPSH “Olive”. Kryesisht në regjistrin e pacientëve ishin të shënuara të gjitha rastet të cilat ishin nga laboratorit IPSH “Mrika”, datat e shënuara në regjistër përputheshin me datat e shënuara me fletoren e IPSH “Mrika” në të cilën evidentoheshin pacientët e dërguar në IPSH “Olive” për testim PCR. IPSH “Olive”, nuk kishte të ruajtura mostrat e marra nga pacientët. Për rastin e pacientes M.H. në deklaratën e vet Dr. M.K. pronare e IPSH “Mrika” ka thënë se mostrën e saj e dërgon në IPSH

“Olive” më datë 03.08.2021, por në mostër e ka të shënuar datën 31.07.2021 kur është marrë mostra. Në kohën e inspektimit ishin prezentë dy mikrobiologë të cilat punojnë në IPSH “Olive”, fletë analizat nënshkruhen prej dy mikrobiologëve në të njëjtën kohë. Disa fletë analiza janë të nënshkuara nga Dr. P.A. e cila në të njëjtën kohë ishte në pushim mjekësor, ndërsa sipas pronarit nënshkrimet mikrobiologët i kanë të deponuara dhe sistemi i qetë automatikisht. Te pjesa e rekomandimeve IPSH “Olive”, i ndalohet marrja e mostrave nga institucionet shëndetësore laboratorike të cilat nuk janë të licencuara për kryerjen e analizave përkatëse.

15. Nga Rezultatet e testimit ISO nga paditësi me listën e pacientëve me të dhënat personale dhe rezultatet e testit për periudhën 23.07.2021, 03.06.2021, 01.07.2021, janë bërë testime për SARS COVID në institucion shëndetësor Olive Group.
16. Nga Kërkesë për pushim nga P.A. me datë 09.09.2021, konstatohet se pushimin mjekësor e ka filluar nga data 10.09.2021 deri më datë 23.09.2021, data e paraqitjes në punë më datë 24.09.2021. Sipas Rezultati mikrobiologjik për pacientin R.K, rezultati i është lëshuar këtij pacienti me inicialet R.K më datë 23.09.2021, dhe i nënshkruar dhe vulosur nga Dr. P.A..
17. Nga Vendimi i shkallës së parë me nr.10/A-70-21 me datë 11.10.2021, i Inspektores Shëndetësore ne IP Ministria e Shëndetësisë, F.S.t si themelues në IPSH Poliklinikë “Olive” laborator biokimik dhe mikrobiologjik është ndëshkuar me gjobë me vlerë prej 3,000.00 euro, për shkelje të dispozitave të Ligjit për Shëndetësi 04/L-1258, me arsyetim se pas verifikimit të dokumentacionit dhe gjendjes faktike të institucionit shëndetësor u konstatua se në këtë institucion kryhet marrja e mostrave për PCR nga laboratorët tjera me një marrëveshje brendshme, të cilat laboratorë nuk janë të licencuara për atë shërbim. Nuk i ruan mostrat e marra nga laboratorët me ç’rast shkaktohet konfuzion përmes datës së marrjes së mostrës dhe datën e punimit të mostrës, ka të deponuar nënshkrimin e mikrobiologëve me ç’rast emri i tyre del në fletanaliza edhe kur ato janë në pushim, për këto arsye është konstatuar se Institucioni Privat Shëndetësor “Olive” me themelues F.S. ka bërë shkelje të nenit 94 par. 1 nën par. 1.3 të Ligjit për Shëndetësi nenit 94 par. 2 nën par. 2.3 dhe par. 4 nën par. 4.4.

18. Fatura me numër 001251 më datë 11.10.2021 nga Ministria e Shëndetësisë-Inspektorati Shëndetësor për pagesë të gjobës në shumë prej 3,000.00 euro është e lëshuar ndaj pronarit F.S.t.
19. Kundër Vendimit nr. 10/A-70-21 datë 11.10.2021, të inspektores A.M., paditësit ka parashtruar ankesën më datë 19.10.2021.
20. Me Vendimin me nr. 10-K-70-21 me datë 17.10.2021, (vendimi i kundërshtuar me kërkesëpadi) Zv. Kryeinspektori Shëndetësor e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e tani paditësit e datës 19.10.2021 duke e lënë në fuqi vendimin e Inspektoratit Shëndetësor me nr. 05-864 të datës 11.10.2021, me arsyetim se në raportin e inspektimit është theksuar se kryhet marrja e mostrave për PCR nga laboratorët e tjera me një marrëveshje të brendshme të cilat laboratorë nuk janë të licencuar për një shërbim të tillë dhe mostrat e tilla nuk ruhet nga këto laboratore me ç'rast shkaktohet konfuzion data e marrjes dhe data e pranimit/punimit të mostrës dhe se Institucioni në fjalë e kishte të deponuar nënshkrimin e mikrobiologëve me ç'rast emri i tyre del në fletë analizën edhe kur profesionisti shëndetësi gjendet në pushim. Ka konstatuar se Vendimi për shqiptimin e dënimit është marrë në pajtim me dispozitat e nenit 94 par. 1 nënpar. 1.3 të Ligjit nr.04/L125 për Shëndetësi.

### Vlerësimi i Gjykatës

21. Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 11 par. 3 të Ligjit Nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor i cili përcakton *Kundër vendimit përfundimtar të Inspektoratit shëndetësor mund të ngritët kontest administrative në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh* dhe Nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se *Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.*
22. Gjykata në radhë të parë shqyrtoj pretendimet e përfaqësuesit të paditësit se me vendimin e kundërshtuar nr. 10/A70-21 të datës 11.10.2021 është dënuar personi F.S. i cili është një nga aksionarët themelues të IPSH Poliklinikë “Olive”, dhe vlerësoj se përfaqësuesi i



paditësit nuk ka ofruar asnjë provë për të dëshmuar se personi fizik F.S. është vetëm aksionar madje as certifikatën e bizesit. Nga të dhënat publike ne ARBK, konstatohet se F.S. është Drejtor Menaxhues i OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C. me numër të regjistrimit të biznesit 812096429.

23. Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar është i bazuar në gjendjen faktike të konstatuar në procesverbalin mbi inspektimin e kryer me nr. rendor 01616 me datës 23.09.2021 si dhe në raportin e inspektimit të datës 17.10.2021. Në inspektimet e kryera është konstatuar se Institucioni IPSH “Olive” ka marrëveshje me laboratorët e tjerë të pa licencuara, se ne kryhet marrja e mostrave për PCR nuk ruhet te dhënat nga këto laboratorë me ç’rast shkaktohet konfuzion data e marrjes dhe data e pranimit/punimit të mostrës, siç është konstatuar rasti i pacientes M.H. në deklaratën e vet Dr. M.K. pronare e IPSH “Mrika” ka thënë se mostrën e saj e dërgon në IPSH “Olive” më datë 03.08.2021, por në mostër e ka të shënuar datën 31.07.2021 kur është marrë mostra. Po ashtu është konstatuar se institucioni në fjale kishte të deponuar nënshkrimin e mikrobiologëve ashtu që emri i tyre del në fletë analizën edhe në rastet kur profesionisti shëndetësor gjendet në pushim. Ky fakt është mbështetur në Rezultatet e testimit ISO nga paditësi me listën e pacientëve me të dhënat personale dhe rezultatet e testit për periudhën 23.07.2021, 03.06.2021, 01.07.2021, kur ishin bërë teste për SARS COVID në institucion shëndetësor Olive Group. Rezultati mikrobiologjik për pacientin R.K, rezultati i është lëshuar këtij pacienti më datë 23.09.2021, dhe i nënshkruar dhe vulosur nga Dr. P.A. në kohën kur e njëjta gjendej në pushim mjekësor nga data 10.09.2021 deri më datë 23.09.2021 të konfirmuar sipas dëshmisë kërkesë për pushim nga P.A. të datë 09.09.2021, që në mënyrë serioze ngrit dyshimit e ekzaminimit të analizave sepse rezulton që nënshkrimi – paraprakisht i deponuar - nuk siguron asnjë garancion për verifikim dhe saktësi të ekzaminimit të analizave.

24. Prandaj gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar është i drejte dhe i ligjshëm i bazuar në fakte të konstatuar në procesverbal me nr. 01616 të datës 23.09.2021 dhe në raportin e inspektimit nga ana e inspektorëve shëndetësor të datës 11.10.2021, andaj vendimi i kundërshtuara nr.10/K-70-21 i datës 17.11.2021 i nxjerrë nga e organi shkallës së dytë të Inspektoratit Shëndetësor, Ud. Kryeinspektori Shëndetësor si dhe vendimi i shkallës së parë i së paditurës me nr. 10/A-70-21 i datës 11.10.2021 i Inspektoratit Shëndetësor

janë marr konform dispozitave ligjore në fuqi, të bazuara në konstatim të drejtë të gjendjes faktike.

25. Shqiptimi i dënimit ndaj personit përgjegjës në cilësi të Drejtorit Menaxhues të IPSH “Olive” tani në cilësinë e palës paditëse është marr për shkak të shkeljes së dispozitave të nenit 94, par.1 nën par. 1.3 i Ligjit Nr. 04/L125 për Shëndetësi, paragrafi 2 përcakton se *“Personi përgjegjës në institucionin shëndetësor dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dymijë (2.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro për shkelje të dispozitave pika 2.3. citon: “neni 52 i këtij ligji për ruajtjen e të dhënave të shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore”.*

26. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi për shpenzime procedurale shpenzimet procedurale u more në bazë të nenit 64 të LKA-së

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.697/22, datë 18.09.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykatë.